



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. ____/____Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: "Megapharm" sh.p.k me NIPT **J61814028F**, Adresa : Tirane, Rruga Elbasanit, Mjull Bathore, përballë TEG"

* * *

Procedura e prokurimit: *"B4-Blerje barna antineoplastike dhe immunomodulatore, si dhe gjaku dhe organet formuese të gjakut", ndarë në 9 lote, për lot 7 Trastuzumab Biosimilar ose origjinator 150 mg.*

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-58365-05-18-2020**

Referenca Lotit: **REF-58382-05-18-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *"B4-Blerje barna antineoplastike dhe immunomodulatore, si dhe gjaku dhe organet formuese të gjakut", ndarë në 9 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj" me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total për të gjitha lotet për 24 muaj 944,845,592 (nëntëqind e dyzet e katër milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH, për lot 7 Trastuzumab Biosimilar ose origjinator 150 mg.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Jo**

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“Delta Pharma – AL” sh.p.k** me NIPT K62202046U Adresa : Autostrada Tiranë – Durrës, km 3, me vlerë oferte totale **425,700** lekë pa TVSH.
2. **“EdnaFarma” sh.p.k** me NIPT K01515004T Adresa: Tiranë, Ish Kombinat Josif Pashko, Laprakë me vlerë oferte totale: **95,142,720** lekë pa TVSH.
3. **”Megapharm” sh.p.k** me NIPT J61814028F, Adresa : Tirane,Rr,Elbasanit, Mjull Bathore, përballë TEG” me vlerë oferte totale **65,156,250** lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

a. Operatori Ekonomik **”Delta Pharma - AL” sh.p.k:**

1. Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme.
2. Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar Në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.

Në shtojcën 1 – Formulari i Ofertës Ekonomike të ngarkuar në sistem, ofertuesi ka paraqitur çmimin për njësi (lekë pa TVSH): 90, ndërkohë që pas hapjes së ofertave, referuar e-mailit të datës 07.07.2020, të dërguar nga anëtarë i Njësisë së Prokurimit, operatori ekonomik ka dërguar kërkesë në sistem duke u shprehur që ka shkruar gabimisht çmimin në euro, në vend të ekuivalentit në lekë dhe ka ngarkuar një formular të ri me çmimin për njësi (lekë pa TVSH) 11160.

Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 53 (Shqyrtimi i ofertave) të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar:

1. *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”*
2. *“Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën”.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

”Megapharm” sh.p.k me NIPT J61814028F, Adresa : Tirane,Rr,Elbasanit, Mjull Bathore, përballë TEG” me vlerë oferte totale **65,156,250** lekë pa TVSH ose çmim për njësi 15,625 lekë.

/pikët totale të marra/[_____]se janë identifikuar si oferta të suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____5_____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **29.07.2020**

Ankesa: Nuk ka

* * *

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

GELARDINA PRODANI